



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 21.14.6-2015-08**

**RAPORT I AUDITIMIT**  
**PËR PROJEKTIN RIVITALIZIMI I SHESHIT TË LIDHJESË SË**  
**PRIZRENIT NË PRIZREN**

*Auditimi sipas Marrëveshjes me UN Habitat No. 09/2013*

**Prishtinë, Tetor 2015**

## 1 Hyrje

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), sipas marrëveshjes Nr. 09/2013 të datës 10 dhjetor 2013 me UN Habitat, ka kryer auditimin final të raportit financiar për projektin “Rivitalizimi i Sheshit të Lidhjes së Prizrenit” në Prizren. Ky projekt është pjesë e programit për mbështetjen e zhvillimit hapësinor Komunal.

Komuna e Prizrenit dhe UN Habitat kishin lidhur marrëveshje për bashkëfinancimin e projektit në vlerë prej 419,550€. Pjesëmarrja e UN-Habitat për këtë projekt ishte 125,802€, ndërsa e komunës 293,748€. Nga buxheti i komunës ishin ndarë 193,748€, ndërsa pjesën tjetër prej 100,000€ e kishte financuar Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).

## 2 Fushëveprimi

Është përgjegjësi e palëve në marrëveshje të përgatisin raportin financiar të projektit. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është kontraktuar që të kryejë auditimin e raportit final financiar si dhe ekzaminimin fizik nëse punët janë kryer sipas marrëveshjes.

## 3 Realizimi i projektit

### **Përshkrimi**

Procedurat e prokurimit për realizimin e këtij projekti ishin zhvilluar nga Komuna, derisa UN-Habitat kishte angazhuar një specialist të prokurimit për të ndihmuar në zhvillimin e procedurave. Tenderi ishte zhvilluar me procedurë të hapur dhe kriter për dhënien e kontratës ishte tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Me datën 28.03.2014 komuna kishte lidhë kontratë me operatorin ekonomik “KOSOVA ERH KOTORI”. Vlera e kontratës ishte 419,550€. Plani dinamik për realizimin e projektit ishte 132 ditë pune.

Gjatë ekzekutimit të kontratës palët kontraktuese ishin pajtuar për të bërë disa ndryshime të projektit nga punët e parashikuara me projektin fillestar. Pas revidimit të projektit, disa pozicione të punëve ishin reduktuar, dhe rrjedhimisht, edhe vlera e kontratës kishte pësuar

ndryshime. Pas revidimit të projektit vlera e kontratës ishte zbritur në 361,287€, me obligim financimi: UN Habitat 102,028€<sup>1</sup>, komuna 159,259€ dhe MMPH 100,000€.

Për të mbikëqyrur realizimin e punëve dhe inspektimin, komuna kishte caktuar Drejtorin e projektit dhe organin mbikëqyrës.

Pas përfundimit të punëve, komuna kishte formuar komisionin për pranimin përfundimtar të punëve. Ky komision në përbërje nga tre anëtar kishte bërë pranimin e punëve të projektit me 28.08.2015. Komisioni për pranimin teknik të punimeve ka vlerësuar se projekti ka përfunduar dhe punët ishin realizuar, por duke i identifikuar disa ndryshime nga projekti.

Ne analizuam nëse projekti është realizuar sipas marrëveshjes në mes të UN-Habitat, Komunës dhe Kompanisë "KOSOVA ERH KOTORI".

### **Të gjeturat**

Me rastin e ekzaminimit fizik të punimeve ne kemi vërejtur se:

- Furnizimi dhe vendosja e kontejnerëve të mbeturinave nuk është punuar sipas kontratës. Kontejnerët e vendosur ishin me kapacitet më të vogël se sa janë kontraktuar;
- Furnizimi dhe vendosja e parkingjeve për biçikleta nuk ishin punuar sipas kontratës duke mos i plotësuar kërkesat që janë kërkuar në kontratë; dhe
- Furnizimi dhe vendosja e ndriçuesve LED për ndriçim dekorativ përgjatë prronit nuk është punuar sipas detajeve të kërkuara.

Mund të konkludojmë se projekti, përkundër mangësive të identifikuara në planifikim dhe implementim, ka arritur të ndryshojë për të mirë pamjen e komunës së Prizrenit, duke i shtuar vlerë kësaj hapësire publike.

Deri në kohën e auditimit, MMPH kishte paguar në tërësi obligimin (100,000€). Komuna nga pjesëmarrja e saj i kishte paguar operatorit 178,979€ e cila paraqet një mbi pagesë prej 19,720€. UN-Habitat i kishte transferuar 76,514€<sup>2</sup> në llogarinë e komunës ndërsa komuna ia kishte transferuar 32,536€ operatorit ekonomik me datën 12.08.2014.

---

<sup>1</sup> Në këtë vlerë është e përfshirë TVSH

<sup>2</sup> Kjo pagesë është pa TVSH

---

Gjendja e pagesave dhe obligimeve sipas kontratës është paraqitur në tabelën në vijim ( €)

Bashkë financuesit	Obligimi i pagesës pas ndryshimit të kontratës (në €)	Fondet e alokuara për financimin e kontratës në llogarinë e komunës	Të paguara në llogari të operatorit ekonomik	Obligimet e mbetura nga kontrata
KK Prizren	159,259		178,979	(19,720)
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	100,000		100,000	0
UN-Habitat	102,028	76,514 <sup>3</sup>	32,536	11,442
<b>Gjithsej:</b>	<b>361,287</b>		<b>311,515</b>	<b>49,772</b>

## 4 Konkluzione

Konkluzioni ynë është se cilësia e punëve të kryera nuk ishte në përputhje të plotë me marrëveshjen për arsye të planifikimit jo të mirë të projektit.

### Rekomandime

#### Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që:

- Shuma e paguar më tepër operatorit ekonomik në vlerë 19,720€ t'i kthehet buxhetit të komunës, ndërsa t'i transferoj operatorit shumën e pa paguar të Habitat-it prej 43,978€ nga llogaria e projektit;
- Të kërkojë nga operatori ekonomik që të evitojë mangësitë e identifikuara; dhe
- Të formohet një komision i përbashkët dhe të rishikoj nëse mangësitë e projektit janë eliminuar.

#### Rekomandojmë UN-Habitat-in që:

- Të mos paguaj shumën e mbetur dhe të pranuar (11,442€), pa u siguruar se janë eliminuar të gjitha mangësitë e projektit; dhe
- T'i lëshojë Kompanisë 'KOSOVA ERH KOTORI' konfirmimin për lirim nga pagesa e TVSH-së.

<sup>3</sup> Kjo pagesë nuk e përmban TVSH-në